


SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI:

“Mirëmbajtje e Thellë të Ashensorëve në objektet arsimore”, Shkolla 1 Maji,



Hartoi relacionin:

"ProStruct Shpk" LIÇ. N7318/1

"infinite R S" LIÇ. N6613/8

Ing.Ndertimi Halim XHIXHA Nr.Lic- K.3521

Ing.Mekanik Altin MARAJ Nr.Lic- M.1380/1

SEKSIONI I: SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Specifikime të përgjithshme

1.1.1 *Njësi Matëse.*

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me kontratat janë metrike në mm, cm, m, m², m³, km, N, mg, °C. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

1.1.2 *Punime të gabuara.*

Cdo punë që nuk është në përputhje me këto specifikime, dhe nuk është paraqitur në projekt, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë cdo difekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

1.1.3 *Tabelat njoftuese etj.*

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur përveç:

Kontraktori do të ndërtojë 2 tabela që përmbajnë informacion të dhënë nga supervizori dhe vendosen në vende të caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip dhe në anglisht.

1.1.4 *Autorizim me shkrim.*

“Rregullat me shkrim” do ti referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga supervizori të dërguara nga kontraktuesi që përmbajnë instruksione, udhëzime dhe orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuar, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instrukturuara, të emëruara, të konsideruara, të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat dhe instruksionet, emërtimet, urdhëresat e supervizorit do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

1.1.5 *Dorëzime të supervizorit.*

Kontraktori duhet të dorëzojë te supervizori për cdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit të supervizorit.

SEKSIONI II – PUNIME, PRISHJE DHE PASTRIMI

2.1.1 **Pastrim i kantierit.**

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike, vegjetariane dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjithë pirgjet e mbeturinave.

2.1.2 *Mbrojtja e vendit të pastruar*

Kontraktori duhet të ngrejë rrjete të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që të parandalojë aksidentime të personave, ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialet që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

SEKSIONI III – STRUKTURA E NDËRTIMIT

3.1 Skeleritë

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë në konform me të gjitha kushtet teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim i objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

3.2 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e shkatërrimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë strukturalë. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të transportohen nga ashensorë, pastaj do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

3.3 Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë:

a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet.

b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me eksperiencë.

b) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit.

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmata, syze mbrojtëse, mbrojtëse veshësh dhe bombola frymëmarrjeje.

3.4 Prishja e dysHEMEVE

Prishja e dysHEMEVE të çfarëdo lloji dhe spostimin e materialeve, jashtë ambientit të kantierit.

3.5 Prishja e veshjeve me pllaka të mureve

Prishje e veshjeve të çfarëdo lloji dhe prishje e llaçit që ndodhet poshtë, pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

SEKSIONI IV- STRUKTURAT METALIKE

4.1 Të dhëna të përgjithshme

Në projektimin e konstruksioneve prej çeliku, duhen marrë parasysh kërkesat që pasqyrojnë veçoritë e punës së këtyre konstruksioneve, me anë të udhëzimeve përkatëse në mbështetje të këtyre kushteve teknike.

Soliditeti dhe qëndrueshmëria e konstruksioneve prej çeliku duhet të garantohet si gjatë procesit të shfrytëzimit, ashtu edhe gjatë transportimit dhe montimit.

4.1.1 Lidhja me bulona

Elementët prej çeliku mund të lidhen/bashkohen edhe me anë të bulonave.

Lidhja me bulona duhet t’u përgjigjet normave dhe standarteve bashkëkohore (EC 3 ose ndonjë norme të ngjashme).

Kualiteti i bulonave luan një rol të rëndësishëm dhe këto të fundit po ashtu, duhet t’u përgjigjen normave dhe standarteve të lartpërmendura. Më shumë rëndësi është që ata t’i plotësojnë kushtet e rezistencës së llogaritjes të bashkimeve me bulona. Lloji i gjendjes së tensionuar dhe grupi i bashkimit, të cilat duhet të përmbushin kushtet e nevojshme/kërkuara nga normat/standartet janë këto:

- Tërheqja
- Prerja
- Shtypja

Gjatë zbatimit të punimeve për lidhjen me bulona të çelikeve duhet të mbahet dokumentacioni teknik më të dhëna për çertifikatën e materialeve të përdorura, ditarin e punimeve etj.

Se çfarë mënyre bashkimi (saldimi apo bulonat) do të përdoret, kjo duhet vendosur nga inxhinieri konstruktor sipas nevojës.

4.1.2 Ngritja

Ngritja e elementëve prej çeliku bëhet sipas planeve të përgatitura nga arkitekti/inxhinieri. Inxhinieri duhet të supervizojë punën e ngritjes. Punonjësit që do të merren me këtë punë duhet të kenë eksperiencë në ngritjen e elementeve prej çeliku.

4.1.3 Mbrojtja nga agjentët atmosferikë

Mbrojtja e çelikut bëhet në dy mënyra:

- Duke e lyer çelikut me disa shtresa, të cilat e mbrojnë çelikut prej korrozionit.

Ajo bëhet duke e lyer, zhytur, ose duke e spërkatur me shtresa. Njëra shtresë është baza, kurse shtresa tjetër përdoret edhe si dekorim i elementit dhe mund të ketë ngjyrë të ndryshme.

Materiali në të cilin do të vendosen shtresat duhet paraprakisht të përpunohet dhe të jetë i lirë nga pluhuri, vaji si dhe nga ndryshku.

- Shtresë prej metali: kjo mbrojtje është e përhershme. Çeliku duhet zhytur në zink të nxehtë (450 °C) dhe sipërfaqja e tij të jetë e lirë prej pluhurit, vajit si dhe prej ndryshkut. Përmbi atë, mund të vendoset ndonjë shtresë tjetër si dekorim i elementit prej çeliku (si psh. bojë).

Ndalohet rreptësisht lyerja e çelikeve për betonim me vajra.

SEKSIONI V- RIFINITURAT

5.1 Rifiniturat e mureve

5.1.1 Suvatimi i brendshëm në rikonstruksiione

Sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash, n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla, si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim me drejtues i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç gëlqereje m- 1: 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

5.1.2 Lyerje me bojë plastike në rikonstruksiion

Lyerje me bojë plastike e sipërfaqeve të brendshme.

Proçesi i lyerjes me bojë plastike i sipërfaqeve të mureve të brendshme kalon nëpër tre faza si më poshtë:

1-Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet.

Para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes, mbushja e gropave të vogla, apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Në rastet e sipërfaqeve të patinuara bëhet një pastrim i kujdesshëm i sipërfaqes. Para fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

5.2 Rifiniturat e dysHEMEVE

5.2.1 Riparimi i dysHEMEVE me pllaka

Riparimi për pllakat e dëmtuara, ose për ato pllaka që mungojnë, të bëhet në këtë mënyrë:

Pllakat e dëmtuara duhen hequr me gjithë llaçin, në një trashësi të paktën 2 cm.

Pastaj duhet, që vendi të pastrohet dhe të lahet me ujë me presion. Pllakat e reja të jenë me të njëjtën ngjyrë dhe me dimensione të njëjta si pllakat e vjetra dhe të vendosen në llaçin e shtruar. Llaçi për riparim duhet të përgatitet me përmbajtje: për 1,02 m² pllaka nevojiten 0,02 m³ llaç të tipit m-15 me 4 kg çimento (marka 400).

Pastaj, duhet që fugat të mbushen me masën përkatëse (bojak), të pastrohen dhe të kryhen të gjitha punët e tjera.

SEKSIONI VI-ASHENSORËT ELEKTRIK

Ashensorët apo liftat janë mjete transportuese për lëvizjen vertikale të njerëzve dhe mallrave Janë pajisje me numër të shumtë të pjesëve dhe elementeve, dhe me kërkesa të mëdha të sigurisë.

6.1 Ashensorët elektrikë

Ashensorët apo liftat janë mjete transportuese për lëvizjen vertikale të njerëzve dhe mallrave. Janë pajisje me numër të shumtë të pjesëve dhe elementëve, dhe me kërkesa të mëdha të sigurisë. Ashensorët përdorin sistemin e ngritjes me ndihmën e litarëve të çeliktë të cilët lëvizin kabinën e udhëtarëve. Për të mundur lëvizjen sa më stabile dhe efikase, kabina e ashensorit është e lidhur em anë të litarëve, nëpër mekanizmin e ngritjes, për kundërpeshë. Ashensori lëviz nëpër binarë në hapësirën e dedikuar posaçërisht, e cila quhet kafaz, që zakonisht është një hapësirë e zbrazët e rrethuar me material të betonit.


Përparësi e tyre është se mund të përdoren për ngritje në lartësi të mëdha dhe kanë shpejtësi të madhe të lëvizjes. Shpejtësia e lëvizjes së ashensorëve është në mes të 0.5 m/s deri 1.5 m/s, e në raste speciale 6-7 m/s. Dobësia e tyre është pesha e kufizuar të cilin mund ta bartin të cilën rreptësisht duhet respektuar gjithmonë.

Në fakt ashensorët elektrikë konsumojnë më pak energji - prandaj janë të qëndrueshëm me mjedisin - në sajë të teknologjive të reja që lejojnë instalimin e makinave pa ulur (lejojnë kursimet e energjisë prej 42%). Përveç kësaj, kanë sistemet automatike të fikjes së dritës kur vërehet se ashensori nuk po funksionon, gjë që sjell pasoja pozitive për kursimin e energjisë.

Vetitë që e karakterizojnë ashensorin në përgjithësi janë :

- Ashensori gjithmonë duhet të jetë i montuar në vendin e shërbimit,
- Stacionet për ngarkim/shkarkim janë të përhershme, të sigurta dhe të qëndrueshme,
- Bartja e ngarkesës bëhet përmes kabinës e cila lëvizë nëpër udhëzueset e veta (shinat) vertikale.
- Devijimi i shinave prej aksit vertikal maksimalisht mund të jetë me një tolerancë prej 15°. Kuptimi i aksit vertikal është drejtimi i vijës së drejtë dhe vertikal të ngarkesës që ka të bëjë në tërë udhëtimin.
- Realizimi i përhershëm i stacioneve të sigurta dhe të qëndrueshme mundëson zbatimin e disa masave të sigurisë në stacione me qëllim të mbrojtjes së shfrytëzuesve të ashensorëve, gjatë ngarkim/shkarkimit të kabinës si dhe hyrje/dalje në ashensor.

Vendosja e ngarkesës në kabinë mbrohet nga rëniet dhe dëmtimet, ndërsa lëvizja e kabinës nëpërmjet udhëzuesve mundëson lëvizjen e drejtë të kabinës dhe e siguron atë në rast të këputjes së pajisjes varëse – litarit i cili e bartë kabinën, nga rënia e lirë.



6.2 Kafazi i ashensorit

Kafazi i ashensorit elektrik me litarë është një hapsirë, në të cilën vendosen shinat e kabinës, shinat e kundërpeshës, nëpër të cilën lëviz kabina dhe kundërpesha, ka dyert nëpër secilin kat dhe nëpër të janë të lidhura instalimet e kablllove, të cilat përcillen deri në kabinë apo në dyert e kafazi. Në kafaz vendosen edhe instalime të tjera përveç atyre të domosdoshme për funksionimin dhe sigurinë e ashensorit, këto pajisje duhet të mundësojnë qasje të lehtë për inspektim dhe riparim.

6.3 Karakteristikat dhe specifikimet teknike te Ashensorit

KARAKTERISTIKAT	
Lift type:	City 300
Use:	Passenger
Rated Load:	525 kg
Speed:	1,00 m/s
Travel:	13.000 mm
Number of stops:	4
Cabin / Shaft entrances	1/4
Power supply:	5.5 kW 3 380V / 50 Hz
Main standard:	EN81-20
Low Pit & Headroom Standard :	NO
Overload:	ANT OMS-720
All-in-One:	Yes
Basin:	Yes

ASHENSORI	
Shaft dimensions(width x depth):	1.600 mm x 1.600 mm
Headroom:	3.830 mm
Shaft type:	SHAFT STEEL
Pit depth:	1.000 mm
Machine room type:	MRL
Machine room position:	LAST FLOOR
Counterweight position:	Right

“Mirëmbajtje e Thellë të Ashensorëve në objektet arsimore”, Shkolla 1 Maji, TIRANË

KABINA E BRENDSHME	
Dimensions (W x D x H):	1100 mm x 1250 mm x 2200 mm
Cabin sides finishing:	St/St for Purity Satin (AISI 441)
Corners-returns finishing:	St/St for Purity Satin (AISI 441)
Skirting:	No
Ceiling type & lighting:	O3 for Purity, LED, Mirror (AISI 430), PPLEXIGLASS CRYSTALIZED
Floor of cabin:	Artificial granite REGAL BLACK
Handrail type:	K3 Ø38 MIRROR, Left, Right, Rear
Mirror type:	Triplex 3+3 (smooth edges), FULL WIDTH - HALF HEIGHT SP, Rear
Mirror Brackets:	0
COP position:	LEFT
Fan:	Yes
Next direction arrows:	No

DERA E ASHENSORIT	
Dimensions (WxH):	900 mm x 2.100 mm
Door type:	2-P Telescopic Right, 40/10 PM, VF7+ CAN Open PM
Door panels:	ST/ST
Panel finishing:	Satin AISI 441
Light curtain:	Yes
Sill type:	AL Standard
Sill with holes:	Yes

DERA E DALJES	
Door position:	Front Entrance
Dimensions (WxH):	900 mm x 2.100 mm
Door type:	2-P Telescopic Right
Door panels:	ST/ST, Satin AISI 441
Door frames:	ST/ST, Satin AISI 441
Doors fire resistance:	E-120
Full façade:	NO
Sill type:	AL Standard
Sill with holes:	Yes
Pre-assembled Door Panels:	No

CABIN OPERATING PANEL (COP)	
COP type:	AKC-BES SATIN
Type of buttons:	RT-42 Class 1
Button / Key switches operations:	Alarm/Door Open/Door Close/Fan Switch/Car Preference
Type of display:	GN-DOTL RED
Communication Device:	Genius safety line
Call 's sequence:	0,1,2,3
Inductive loop for hearing-impaired passengers:	No
Voc - Type:	without

Standartet:

- SSH EN 1993-1-1 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-1: Rregullat e përgjithshme dhe rregullat për ndërtesat (Eurocode 3: Design of steel structures General rules and rules for buildings)
- SSH EN 1993-1-2 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1- 2: Rregullat e përgjithshme - Projektimi strukturor për zjarrin (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-2: General rules - Structural fire design)
- SSH EN 1993-1-4 Eurokodi 3 - Projektimi i strukturave të çelikut - Pjesa 1-4: Rregulla të përgjithshme - Rregulla shtesë për çeliquet e paoksidueshëm (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-4: General rules -

Supplementary rules for stainless steels) • SSH EN 1993-1-5 Eurocode 3 - Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-5: Elementët strukturor pllakë (Design of steel structures - Part 1-5: Plated structural elements)
• *SSH EN 1993-1-6 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-6: Rezistenca dhe stabiliteti i strukturave guackore (Eurocode 3 - Design of steel structures - Part 1-6: Strength and Stability of Shell Structures)*
• *SSH EN 1993-1-8 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1- 8: Projektimi i xhuntimeve (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-8: Design of joints) SSH EN 1993-1-10 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-10: Rezistenca e materialit dhe vetitë nëpërmjet trashësisë (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-10: Material toughness and through-thickness properties)*
• *SSH EN 1993-1-11 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-11: Projektimi i strukturave me komponentë në tërheqje (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-11: Design of structures with tension components)EN 1994-1-1 Design of composite steel and concrete structures – General rules and rules for buildings*
• *SSH EN 1994-1-2 Eurokodi 4: Projektimi i strukturave kompozite çelik dhe beton - Pjesa 1-2: Rregulla të përgjithshme – Projektimi strukturor ndaj zjarrit(Eurocode 4: Design of composite steel and concrete structures - Part 1-2: General rules - Structural fire design)EN 1998-1 Design of structures for earthquake resistance – General rules, seismic actions and rules for buildings • SSH EN 1998-5 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit - Pjesa 5: Themelet, strukturat mbajtëse dhe aspekte gjeoteknike(Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance - Part 5: Foundations, retaining structures and geotechnical aspects)*

Hartoi relacionin:

"ProStruct Shpk" LIÇ. N7318/1

"infinite R S" LIÇ. N6613/8

Ing.Ndertimi Halim XHIXHA Nr.Lic- K.3521

Ing.Mekanik Altin MARAJ Nr.Lic- M.1380/1